

Bisedë me Nikollë Shabanajn, kryetar i Bashkimit të Intelektualëve Shqiptarë në Mërgim-BISHM

Për çështje kombëtare diaspora shqiptare është gjithmonë unike

Bota sot: Z. Shabanaj, cili ka qenë roli i diasporës shqiptare para dhe gjatë luftës në Kosovë dhe cili është sot?

N. Shabanaj: Kur unë mërgova në Gjermani, në fund të viteve '80, takimin e parë me veprimtarë të çështjes sonë kombëtare e pata në Kaiserslautern. Pikërisht atje u njoha me disa veprimtarë legalistë, të cilët më parë kishin qenë tejet aktiv në kryeqytetin francez, Paris. Ata rrëfenin shumë tregime se si i shkatërroi Sigurimi i Enver Hoxhës dhe Udba jugosllave. Përshtypje të veçanta më bënë sidomos mërgimtarët shqiptarë në Stuttgart, bashkëpunëtorë të dëshmorëve Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka. Po ashtu, në Bruksel u njoha nga afër me aktivitetin humanitar të mërgimtarëve tanë në kuadër të Shoqatës "Anton Çeta". Në këtë shoqatë dhashë ndihmesën time edhe unë, prandaj Kryesia e saj, më 24.10.1990, më dekoroi si "Anëtar nderi".

Qysh atëherë e deri më sot nuk e kam ndërprerë asnjëherë aktivitetin tim në shërbim të çështjes sonë kombëtare. Sigurisht angazhimet e mia nuk kanë qenë thjesht personale, por të inkudruara mirë në kontributin e diasporës, e cila ka pasur e ka një rol të jashtëzakonshëm për zgjidhjen e çdo problemi. Roli i saj mori peshë të veçantë kur u formua Lidhja Demokratike e Kosovës, e udhëhequr nga kryetari i saj, Dr. Ibrahim Rugova. Atë kohë, jo vetëm që ishin anëtarë e simpatizantë të saj i madh e i vogël në Kosovë, por edhe ne, që kishim dalë në mërgim nga viset e tjera shqiptare, si dhe shteti amë, Shqipëria, ishim unik në mbështetje të vizioneve dhe punës së saj. Qëndrimet e Qeverisë së Kosovës në egzil, fillimisht me seli në Ulm, e më pas në Bonn gjenin përkrahjen e pakontestueshme të të gjithë ne, mërgimtarëve..

Për të qenë më konkret në përgjigjen për pyetjen tuaj, po i referohem një shembulli: në kohën para se të ndahej veprimi i shtabeve emergjente për luftën në Kosovë, në qytetin ku unë ende jetoj edhe sot, në Ludwigshafen, bashkëkombasit me zgjedhën kryetar të Shtabit emergjent në Ludwigshafen, Landi Rheinland-Pfalz. Në një kohë rekord, brenda 8 ditëve, mblodhëm 427 mijë marka gjermane për t'i dërguar në vendlindje. Kurse aktualisht,



Një takim i përzemërt e vëllazëror. Kryeministri Berisha në takim me akademik Mark Krasniqin e Nikollë Shabanajn

me këtë ftohje që vërehet te disa veprimtarë, rrjedhojë e reflektimeve të ndikuara nga vendlindja jonë, nuk besoj se mund të arrijmë të mblidhnim as gjysmën e tyre në një Fond të përbashkët.

Bota sot: Tashmë ekzistojnë dy shtete shqiptare, Shqipëria dhe Kosova. Ç'bëjnë ato për diasporën shqiptare?

N. Shabanaj: Me zhvillimin e ngjarjeve gjatë dhe pas luftës në Kosovë, në diasporë, veç të tjerave, spikati si Asociacioni lidhës Bashkimi i Intelektualëve Shqiptarë në Mërgim-BISHM. Në të bëjnë pjesë mërgimtarë me bindje politike të ndryshme, por që udhëhiqen nga një motiv i lartë atdhetar - kontributi i përbashkët për vendin e origjinës nga diaspora shqiptare. Si i tillë BISHM u vu gurthemel në fund të vitit 2003 për themelimin e „Lobit shqiptar në Evropën perëndimore“ me përpjekje maksimale rreth tre vite për të afruar ne mes veti për bashkëpunim unik ja arritëm në një formë jo te përkryer por rrethnat nuk prisnin dhe shpalsëm Platformën dhe nismën e funksionimit të Lobit si Subjekt ambelle ne diasporë, në fund të vitit 2006

, menjëherë në mesin e festave të fundvitit Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri morëm takim me përfaqësues të dy qeverive. Në Shqipëri na priti këshilltarja për çështje ekonomike e Kryeministrit Sali Berisha, znj. Suzana Guxholli, kurse në Kosovë na priti Kryeministri i asaj kohe, z. Agim Çeku. Pra, dy qeveritë, e Shqipërisë dhe e Kosovës, na kanë mbështetur e na mbështesin në veprimtarinë tonë. Dhe ky është një stimul i fuqishëm për ne. Por sidoqoftë nga ne kërkohet të jemi edhe më aktivë në diasporë. Të gjithë ne i njohim pak a shumë treguesit e emigracionit shqiptar, sidomos në dy dekadat e fundit. Kryeministrin Berisha e njoftova se tani "ka ardhur puna deri te i Zotit i shtëpisë". Kjo konsideratë vlen edhe për të Zotin e shtëpisë në Kosovë, Kryeministrin Taçi, të cilit të njëjtën gjë ia kam deklaruar në një takim në kuadër pavarësisë së Kosovës. Ne si diasporë jemi përherë të gatshëm dhe do të mirëprisnim me shumë dëshirë çdo ftesë të dy qeverive tona për takime pune për konkretizimin e angazhimit të vazhdueshëm për ekonominë shqiptare. Gjetja e modaliteteve si të vihet më mirë në lëvizje diaspora jonë gjykoj se është detyrë e

të dy qeverive dhe intelektualëve me struktura që janë aktive në diasporë.

Bota sot: A është e bashkuar sa duhet diaspora shqiptare për çështjen kombëtare? Po për interesa politike a vihen raste përçarjeje?

N. Shabanaj: Unë kam bindjen e patundur se për çështje kombëtare diaspora shqiptare do mbetet gjithmonë unike. Këtë e dëshmoi më së miri lufta në Kosovë. Nuk dua të zgjatem duke sjellë shembuj për këtë. Ndërsa interesat politike të partive jo rrallë herë ngjallin përçarje në diasporë. Unë i kuptoj disa bashkatdhetarë në diasporë që kanë prirje dhe janë të aftë në politike, madje kontributi i tyre duhet konsideruar vlerë kombëtare.

Bota sot: Ju bashkë me akademik Mark Krasniqin keni takuar ditë më parë Kryeministrin e Shqipërisë, z. Sali Berisha. Çka ju tha kryeministri shqiptar Berisha?

N. Shabanaj: Po, bashkë me akademik Mark Krasniqin ne patëm një bisedë rreth 45 minuta

me kryeministrin Sali Berisha Takimi ishte shumë i veçantë. Për nga mbresat e krahasoj me dy takime të tjera: i pari, me z. Berisha kur kishte vetëm tri javë që ishte zgjedhur President i Shqipërisë demokratike dhe ku unë kisha shkuar si përfaqësues i Fondacionit Ekonomiko-Kulturor "Müller-Oberhofer"; i dyti, me Presidentin Rugova në Kosovën e lirë. Të takosh z. Berisha së bashku me akademikun Mark Krasniqi, simbolin e revolucionit tonë kombëtar, parlamentarim më të vjetër të shtetit më të ri në botë, Kosovës, është kënaqësi e rrallë për çdo veprimtar nga diaspora, kënaqësi të cilën e ndaj bashkarisht me të gjithë bashkëveprimtarët e mi.

E ruaj të freskët në memorie gjithçka u bisedua dhe u konkludua në atë takim.

P. sh., Prof. Dr. Sali Berisha, kur po flisnim për disa probleme që preokupojnë partitë shqiptare në Mal të Zi, përmendi rastin e vendosjes së kufirit në mes të Kosovës dhe të Maqedonisë.

"Kur u vu kufiri në mes Kosovës dhe Maqedonisë, tha ai, nuk ishte e mundur që dikujt personalisht të mos i jenë bërë dëme, por ama Kosova, për të cilën u derdh shumë gjak dhe u bënë sakrificat të mëdha, fitoi kufirin e saj të shtetit sovran me atë shtet fqinj".

Problemet e shqiptarëve, vazhdoi ai më poshtë, po zgjidhen duke pasur mbështetje e fuqishme të Bashkësisë Europiane dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por dhe në sajë të vetë angazhimit të shqiptarëve kudo që ndodhen.

Gjithashtu z. Berisha nënvizoi kontributin që ka dhënë e vazhdon të japë diaspora shqiptare në kuadër të sukseseve të arritura. Ai na njoftoi edhe se ndërtimi i infrastrukturës rruqore do vazhdojë, madje, në plan të shpejtë, tha ai, do të fillojë ndërtimi i një arterieje të rrugës së Adriatikut, ajo Shëngjin-Ulqin. Mesazhi i Kryeministrit Berisha ishte tejet i qartë:

"Shqipëria mirëpret çdo shqiptar të diasporës t'i bashkëngjitet asaj dhe trevave të tjera shqiptare në ndërtimin e vendit, që sa më parë të hyjmë në familjen europiane si vend i zhvilluar".

■ Bisedoi Bajrush Morina